

Wh. Prot 288

dt. 19.12.2011

*Reparto 10000  
dhe t'ni zef  
10 x/1/2011*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE  
DHE EDUKIMIT NË VAZHDIM**

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania Tel. +355 4 364 632 [www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Nr. 4460 / Prot.

Tiranë, më 15.12 2011

Drejtuar: \_\_\_\_\_

**Lënda: Dërgohet urdhri i Ministrit**

Bashkëngjitur do të gjeni urdhrin e Ministrit me Nr 511, datë 13.12.2011  
"Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik"

**Duke Ju falënderuar,**

**DREJTOR**  
*[Signature]*  
**PETRIT PONARI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
KABINETI

Bulevardi "Zef Pashë Curri" Tiranë, Albania Tel/Faks +355 4 362 937 [www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Nr. 7400 / 2011

Tiranë, më 13/12 / 2011

**URDHËR**

Nr. 511, Datë 13/12 / 2011

**"PËR KRITERET  
E PUNËSIMIT NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR PUBLIK"**

Mbështetur në nenin 102.pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe VKM nr 176 datë 29/03/2006 "Për botimin e buletinit të njoftimeve publike" me qëllim për të rritur cilësinë e shërbimit në institucionet shëndetësore duke përzgjedhur specialistët më të kualifikuar të sektorit të shëndetësisë:

**URDHËROJ:**

1. Punësimi në institucionet shëndetësore të bëhet vetëm nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në kritere të përcaktuara.
2. Njoftimi për vendet e lira të punës të bëhet në Buletinin e Njoftimeve Publike .
3. Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna mbi vendin e punës , kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacionin që duhet paraqitur, vendin dhe kohën e dorëzimit të dokumenteve si dhe kërkesa të tjera të nevojshme.
4. Kërkesa të detyrueshme për të konkuruar për një vend të lirë pune janë diploma, certifikata e notave, certifikata e specialitetit (të noterizuara), leja e ushtrimit të profesionit nga urdhri i profesionistëve përkatës, referenca nga punëdhënësit e mëparshëm. ndërsa kriteret të vlerësimit me pikë të kandidatëve janë nota mesatare, provimet pas diplomimit, gjuhët e huaja, gradat apo titujt shkencor, kurse të ndryshme kualifikimi etj.
5. Konkurrimi për një vend pune është i hapur me përjashtim të kandidatëve që lëvizin nga një rreth në tjetrin të cilët duhet të kenë marrë miratimin nga drejtuesi i institucionit i si dhe miratin për transferimin nga Ministri i Shëndetësisë.

6. Kandidati që konkurron për një vend të lirë pune, përveç vlerësimit që i bëhet dokumentariori, të tij, i nënshtrohet detyrimisht një interviste para një komisioni ad-hoc i përbërë jo më pak se tre persona, ngritur nga titullari i institucionit . Intervista vlerëson motivimin për punë, personalitetin, njohjen e gjuhëve të huaja, aftësinë komunikuese, etj.

7. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

▪ **Noti mesatare**

- Mbi 9	vlerësohet	15 pikë
- Mbi 8	"	12 pikë
- Mbi 7	"	8 pikë
- Mbi 6	"	4 pikë
- Mbi 5	"	2 pikë

- Grada apo titulli shkencor *ose specializim* vlerësohet 20 pikë.
- Gjuha e huaj e vërtetuar vlerësohet 3 pikë
- Përvoja më 10 vjet vlerësohet 5 pikë.
- Intervista (maksimalisht) vlerësohet 10 pikë.

8. Pas përzgjedhjes së kandidatit, emërimi i konkurrentit bëhet nga drejtuesi i institucionit përkatës.

9. Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrat Shëndetësore do të zbatohet VKM Nr. 857, datë 20.12.2006 ( i ndryshuar ) "Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore", rregullorja e funksionimit të bordit të qendrave shëndetësore në nivel DRSH/DSHP/ASHR dhe statuti i qendrës shëndetësore.

10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për procesin e përzgjedhjes, brenda 5 ditëve pranë Drejtorive përkatëse.

11. Në këtë urdhër nuk përfshihen kriteret e punesimit në spitalet universitare.

**12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**MINISTRI**

**PETRIT VASILI**